



| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN | |
| 02 Nr. / Br | 212/24 |
| Nr. i fq. / Br. sf | -02- |
| Data: / Datum | 05.03.2024 |
| VUSHTRRI - VUÇITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe me rekomandim të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 04.03.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Anulohen thirrjet publike, të publikuara në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, për projektin “Komuna për të Rinjtë”, (M4Y) faza e dytë për nëngrante të financuar nga Qeveria e Japonisë, administruar nga Banka Botërore, dhe me bashkëfinancim nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Komuna e Vushtrrisë, sipas marrëveshjes së Mirëkuptimit nr. 740/21, datë 30.06.2021.
2. Thirrjet publike që anulohen:
 - 2.1 Thirrjet publike për grante të vogla dhe të mëdha të publikuara më 05.10.2023
 - 2.2 Thirrjet publike për grante të vogla dhe të mëdha të publikuara më 26.12.2023
3. Obligohet Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri që të ndërmerr veprime të nevojshme për publikim të thirrjes tjetër publike përmes zyrës për informim të komunës, për projektin “Komuna për të Rinjtë” – faza e dytë për nëngrante.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Me këtë vendim njoftohen: Ministria e Pushtetit Lokal, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

A r s y e t i m

Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të aplikacioneve për financim të projekt propozimeve për projektin “Komuna për të Rinjtë” (M4Y) faza e dytë për nëngrantet, me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve ka publikuar në fb. e komunës dhe e ka tërhequr pas pak listën e përfituesve të këtij projekti. Kjo listë nuk ka qenë e zyrtarizuar me nënshkrimet e anëtarëve të komisionit. Nga Drejtoria për Kulturë rini dhe Sport poashtu kemi marrë informacione se në atë listë janë përzgjedhë përfitues në baza familjare ku në një rast ishin përzgjedhë dy projekte përfitues të së

njëjtës familje. Është konstatuar gjithashtu se në procesin e përzgjedhjes ka pasë edhe parregullsi tjera të cilat e kanë bërë implementimin e këtij projekti dhe vet procesin e përzgjedhjes jo të besueshëm pasi ka dyshime se nuk është bërë përzgjedhja meritore e aplikuesve si dhe nuk janë respektuar në plotëni dispozitat e nenit 3 të Marrëveshjes së lidhur dhe nënshkruar nga Komuna e Vushtrrisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal, si dhe rregullat e përcaktuara nga donatori.

Bazuar në të cekurat më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

